



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar  
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Prill 2018

# Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [ 4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr. Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)
  
- E-mail: [valdrin.misiri@unhz.eu](mailto:valdrin.misiri@unhz.eu)
- Website: [www.unhz.weebly.com](http://www.unhz.weebly.com)

# Objektivat e ligjerates

- Financiami i korporates me aksione
- Natyra e korporatave
- Llojet e aksioneve
- Kapitali i korporates
- Aksionet te autorizuara, te shitura dhe me zoterim
- Vlera nominale e aksioneve
- Kontabiliteti per aksionet e shitura (emetuara)

# Natyra e korporatave

- Sa i përket vëllimit të operacioneve dhe shumës së kapitalit, në rrethanat bashkëkohore, korporatat janë formë dominante e organizimit biznesor.
- Popullariteti i madh i organizmit të biznesit, si korporatë mund t'i atribihet avantazheve që kanë ato në krahasim me firmat individuale dhe ato pratore.
- Përparësitë e korporatës janë të ndikuara drejtëpërdrejt nga karakteristikat që posedon kjo formë e organizimit biznesor.

# Karakteristikat kryesore të korporatës

- Entitet legal (ligjor) i vecantë
- Jetëzgjatja e pakufizuar dhe transferimi i pronësisë
- Përgjegjësia e kufizuar e aksionarëve ndaj detyrimeve të korporatës
- Lehtësia në sigurimin e kapitalit
- Menaxhmenti profesional i vecantë nga pronarët
- Tatimet e korporatës
- Respektimi strikt i rregullativës ligjore

# Llojet e aksioneve

- Ekzistojnë dy lloje të aksioneve:
  - Aksionet e rregullta (zakonshme)
  - Aksionet preferenciale
- Aksionet e rregullta të një kompanie përfaqësojnë pronësinë e saj riziduale, ndërsa në kuptimin e bilancit pasuritë neto të saj.

# Llojet e aksioneve

- Aksionet e rregulta janë letra me vlerë me të ardhura variablie, cka do të thotë se pronarëve të saj nuk u sigurojnë të ardhura të garantuara më parë dhe se realizimi i tyre varet kryesisht nga realizimi i fitimit të ndërmarrjes.
- Pronësia, mbi aksionet e zakonshme, zotëruesit të saj i siguron të drejta dhe privilegje të ndryshme. është me rëndësi të theksohet se të gjitha të drejtat që sigurohen nga aksionet e zakonshme ndaj shoqërisë aksionare realizohen mbi bazën e vlerës nominale të tyre.

# Llojet e aksioneve

- Të drejtat e aksionarëve, ndaj ndërmarrjes kategorizohen, në këto tipe kryesore:
  - Të drejtat e votës
  - Të drejtat e dividendit
  - Të drejtat e likuidimit
  - Të drejtat e zgjedhjes
- Në aspektin praktik mund të themi së të drejtat e votës janë të drejta jomateriale, kurse tri tipet tjera të të drejtave, në fakt janë të drejta materiale



# Të drejtat e aksionarëve

- **E drejta e votës** – Ajo konsiston në të drejtën e aksionarit për zgjedhjen e bordit drejtues si dhe në të drejtën e votimit për të gjitha problemet e ndërmarrjes që lidhen me menaxhmentin e ndërmarrjes
- **E drejta e dividendit** – së aksionarëve konsiston në të drejtën e aksionarëve për pjesëmarrje në shpërndarjen neto të fitimit.
- **E drejta e likuidimit (falimentimit)** – nënkupton të drejtën e pjesëmarrjes së aksionarit në shpërndarjen e pasurisë së ndërmarrjes kur ajo falimenton. Në rastet e tilla nga shitja e pasurisë, së pari përmbushen detyrimet ligjore ndaj kreditorëve kurse pjesa tjetër e mbetur shpërndahet ndërmjet aksionmbajtësve të zakonshëm.

# Dallimi i aksioneve të rregullta dhe obligacioneve

- Për dallim nga obligacionet, aksionet e rregullta nuk kanë maturim dhe meqenëse nuk kërkohet kthimi i investimit fillestar, ato shërbejnë ndërmarrjes si burime të përhershme të financimit.
- Shlyerja e plotë e aksioneve të zakonshme ndodh vetëm kur falimenton ndërmarrja, prandaj në qoftë se vjen deri te një situatë e tillë, aksionarët bartin rrezikun e humbjes vetëm për kapitalin e investuar.

# Aksionet preferenciale

- Aksionet preferenciale njihen në praktikën financiare si letra me vlerë hibride, të cilat përdoren si burime afatgjata, për financimin e ndërmarrjes.
- Vetë emërtimi letra me vlerë hibride, na bën të kuptojmë së këto instrumente financiare, në njërën anë, kanë vecori të aksioneve të rëndomta sepse në qoftë se nuk mund të paguhet dividendi, ndërmarrja nuk është e rrezikuar të falimentojë
- Anën tjetër, kanë vecori të obligacioneve nga vetë fakti se dividendi i tyre është fiks.

# Vecoritë e aksioneve preferenciale

- Nga aspekti praktik të funksionimit të tyre, këto letra me vlerë i posedojnë këto vecori kryesore:
  - Vlerën nominale
  - Shkallën e dividendës
  - Kushtin e thirrjes (shlyerjes)
  - Afatin e shlyerjes

# Kapitali i korporatës

- Konform Standardeve Ndërkombetare të Kontabilitetit kërkohet që bilancet e korporatave, në mënyrë koncize, të raportojnë burimet e kapitalit të tyre.
- Kapitali i korporatës vjen prej dy burimeve themelore:
  - Kapitali i kontribuar
  - Fitimi i mbajtur

# Vlera nominale e aksioneve

- Aksionet e zakonshme, si komponent i kapitalit aksionar, posedojnë vlerën e tyre nominale e cila në esencë përfaqëson shumën e kapitalit ligjor për aksion.
- Vlera nominale shënohet në aksion në momentin e emetimit të tij dhe përcaktohet nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjes.

# Kontabiliteti për aksionet e shitura

- Aksionet e rregullta korporatat i shesin:
  - Me kesh
  - Me pasuri jo kesh dhe shërbime të tjera
  - Regjistrim i aksioneve

# Shitja e aksioneve të rregullta baras me vleren nominale

- Kur aksionet e rregullta shiten baras me vlerën nominale atëherë ndikohen dy llogari dhe atë: debiton llogaria e keshit për vlerën e shitjes dhe për të njejtën shumë, përkatësisht për vlerën nominale të tyre krediton llogaria aksionet e rregullta



# Shembull:

- Korporata “XYZ” në datën e themelimit me statutin e saj, është autorizuar për emetimin e 120.000 aksioneve të rregullta. Me 10 shkurt 2016 ajo ka shitur në kesh 30.000 aksione të rregullta sipas vlerës së tregut 4€ për aksion. Vlera nominale e këtyre aksioneve është gjithashtu 4€.

# Shitja e aksioneve të rregullta me premi

- Shumica e korporatave, aksionet e rregullta i shesin me një cmim më të lartë nga vlera nominale. Kur aksionet shiten mbi vlerën nominale, atëherë për vlerën nominale krediton llogaria aksionet e rregullta, kurse për tepricën mbi vlerën nominale krediton llogaria premia në aksionet të rregullta

# Shembull

- Korporata “XYZ” me 25 mars 2016 ka shitur në kesh 20.000 aksione të rregullta sipas vlerës së tregut 10€ për aksion.
- Vlera nominale e këtyre aksioneve është 5€.

# Shitja e aksioneve të rregullta me pasuri jo kesh

- Në disa raste aksionet e rregullta në praktikë shiten, përkatësisht këmbehen edhe me pasuri jokesh sic janë: patundshmëritë, impiantet, pajimet etj.
- Gjithashtu ato mund të këmbehen me shërbime si p.sh. kompenzimet për konsalting

# Shembull

- Supozojmë së korporata “XYZ” me 15 maj 2016 ka blerë një makineri nëpërmjet 5000 aksioneve të rregullta të vlerës nominale 5€. Në rastin e blerjes së makinerisë, aksionet e rregullta të korporatës janë shitur në bazë të vlerës së tregut(bursë) nga 12€ për aksion

# Shitja e aksioneve pa vlerë nominale

- Disa shtete i lejojnë korporatat për ti shitur aksionet e rregullta, në të cilat nuk është shënuar vlera nominale.
- Meqenëse vlera nominale nuk është e specifikuar me statutin e korporatës ato mund të shiten pa vlerë nominale.
- Kur korporatat shesin aksione pa vlerë nominale, atëherë kapitali ligjor për aksione definohet me ligjet e shtetit përkatës

# Shembull

- Me 8 korrik 2016 korporata “XYZ” ka shitur me kesh 3200 aksione të rregullta sipas cmimit të tregut 12€ për aksion. Aksionet e shitura nuk posedojnë vlerë nominale.
- Beni evidencen kontabel.

# Shitja e aksioneve preferenciale

- Aksionet preferenciale, ngjajshëm me aksionet e rregullta, mund të shitën me kesh dhe pasuri jo kesh.
- Transaksionet për aksionet e preferenciale regjistrohen në kontabilitet ngjajshëm me aksionet e rregullta



# Shembull

- Supozojmë se me 20 gusht 2016 korporata “XYZ” ka shitur 4300 aksione preferenciale në kesh të vlerës nominale 35€. Këto aksione janë shitur në bursë me cmim të tregut per 45€ për aksion
- Beni evidencen kontabel.

# Kontabiliteti i aksioneve të thesarit

- Termi aksione të thesarit (trezorit) i referohet numrit të aksioneve të riblera nga korporata prej aksionarëve të vet, të cilat më parë u janë shitur atyre dhe së të njëjtat nuk anulohen. Ato mund të shprehen:
  - **Aksionet e thesarit = Aksionet e shitura – Aksionet në zotërim**

# Aksionet e thesarit

- Aksionet e thesarit mund të mbahen brenda korporatës për kohë të pakufizuar dhe po ashtu mund të shiten në cdo kohë. Aksionet e thesarit krijohen prej korporatës për disa qëllime sic janë:
  - *Për t'u dhënë bonus menaxherëve dhe punëtorëve të saj nëpërmjet opcioneve të aksioneve*
  - *Për të ndikuar në cmimin e aksioneve, sepse një numër më i vogël i aksioneve në zotërim do të ndikojë në rritjen e cmimit të aksioneve.*
  - *Duke i blerë aksionet e saja korporatat pakësojnë mundësinë e blerjes së tyre nga korporatat e tjera dhe marrjen e kontrollit nga ato.*

# Blerja e aksioneve të thesarit

- Evidenca kontabël e blerjes së aksioneve të thesarit bëhet me metodën e kostos. Kjo nënkupton se kur blihen ato, debiton llogaria e aksionet e thesarit për koston e tyre, që praktikisht nënkupton shumën e paguar për blerjen e tyre.

# Shembull:

- Korporata me 5 shkurt 2016 korporata “XYZ” ka blerë në kesh 1000 aksione të rregullta prej aksionarëve të vet për 10€ për aksion. Vlera nominale e këtyre aksionëve është 5€.
- Bëni regjistrimin kontabel.

# Rishitja e aksioneve të thesarit

- Aksionet e thesarit mund të shiten me një vlerë më të lartë ose të ulët ndaj kostos së blerjes së tyre.
- Me rastin e shitjes së tyre për koston e blerjes, krediton llogaria aksionet e thesarit (trezorit), kurse për diferencën më të lartë ose më të ulët nga kostoja krediton ose debiton llogaria premia në aksionet e thesarit.

# Shembull

- Korporata “XYZ” me 15 prill 2016 ka shitur 500 aksionet e thesarit nga 12€ për aksion. Kostoja e blerjes ka qenë me 5 shkurt ka qenë 10€ për aksion.
- Dhe ne rastin kur kjo korporatë ka shitur 600 aksione të thesarit nga 8€ për aksion.

Pyetje



Suksese!